



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:131762

Datë: 03.06.2024

Numri i dokumentit: 05771781

P.nr. 149/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti, me sekretaren juridike Fatmire Podvorica si procesmbajtëse dhe bashkëpunëtorit profesional Muhamet Musliu në çështjen penale kundër të pandehurit G. S., për shkak të veprës penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 401 par. 1 KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1960/2024, të datës 07.05.2024, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 03.06.2024, në të cilin ish-in të pranishëm Prokurori i Shtetit Besart Mustafa dhe i pandehuri, në të njëjtën ditë mori publikisht, shpalli dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

G. S., nga i ati S. dhe nena Sh. mbiemri i vajzërisë T., i lindur më datë ..., me vendbanim në P. Rr. "H. R.", ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes se mesme ekonomike, me nr. personal..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Ekziston dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri G. S. me datë 19.04.2024, rreth orës 23:00 në hapësirën, e Shtëpisë së Shëndetit në P., i mllefosur, me pretendimin se infermierja, tani e dëmtuara F. R., nuk e kishte kryer punën e saj si duhet i njëjti e kishte kërcënuar seriozisht të njëjtën me fjalën se "kam me t'i nuk flokët" me ç 'rast të dëmtuarës i kishte shkaktuar ndjenjën e ankthit, frikës dhe të pasigurisë për jetë..

- Me këtë i pandehuri G. S. ka kryer veprën penale: **Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par.1 të KPRK-ës..**

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 9, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe nenit 401 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 364, 365, 368, 369, 449, 452 dhe 462 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

I. Të akuzuarin me dënim me burg në kohëzgjatje tre (3) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

II. Konform nenit 44 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit dënimi me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muaj i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën **300.00€ (treqind euro)**, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, e në rast se nuk e paguan atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro të papaguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burgim, konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

III. Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

IV. E dëmtuara F. R. nga fshati B.- Komuna e P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko - civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.1960/2024, të datës 07.05.2024,, kundër të akuzuarit G. S., nga P., për shkak të veprës penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 401 par. 1 KPRK-së

Lidhur me këtë çështje penale gjykata caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 03.06.2024, gjatë të cilës prezantuan Prokurori i Shtetit Besart Mustafa nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, dhe i pandehuri, ndërsa mungon e dëmtuara F. R. për të cilën gjykata ka dëshmi se është ftuar në mënyrë të rregullt ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar.

I pandehuri pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit deklaroi: E pranoj fajësinë, më vjen keq që ka ndodhur rasti, i kërkoj falje të dëmtuarës, atë natë e kam pasur nënën për tretman mjekësor, kam qenë i stresuar, e tërë kjo ka ndodhur për shkak se më kanë udhëzuar të shkoj në emergjencë, pastaj emergjenca nuk më ka ofruar shërbimin dhe më ka udhëzuar për spital, kërkoj nga gjykata një dënim sa më të lehtë për shkak të kushteve të dobëta ekonomike.

Prokurori i Shtetit Besart Mustafa lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit sepse i njëjti është bërë me vullnetin e tij të plotë dhe bazuar në shkresat e lëndës. I propozoj gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, ndërsa si rrethanë lehtësuese ta merr pranimin e fajësisë dhe pendesën e të pandehurit, ndërsa si rrethanë rënduese ta merr intensitetin e dashjes së të pandehurit aprovoj pranimin e fajësisë, dhe pranimin e fajësisë ta marrë si rrethanë lehtësuese.

Gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban Aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit, dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimi të fajësisë nga i akuzuari, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 par.2 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga vet të akuzuarit, gjykata vlerëson se në veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushën të gjitha elementet qenësore të veprës penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 401 par. 1 KPRK-së, për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës dhe të njëjtin e shpalli fajtor, andaj i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, është penduar ndërsa si rrethanë veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Andaj gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit, të dënimit me burgim në dënim me gjobë është marrë në kuptim të nenit 44 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 43 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.2 nën par. 2.6 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par. 3 nën-par. 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontestin civil është marrë në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.149/2024 me dt.03.06.2024.

Sekretare juridike
Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj Gjykate.